

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj, kryetare, Fillim Skoro gjyqtar referues e Have Haliti, anëtare, me bashkëpunëtorin profesional Sadik Kryeziu, procesmbajtës, në lëndën penale të akuzuarit D.J., nga Ferizaji, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore DKR në Prishtinë, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, P.nr.543/2016, të dt.19.07.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 10.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ankesa e PTH-DKR në Prishtinë, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore -DKR në Prishtinë, P.nr.543/2016, të dt.19.07.2018, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore –DKR, në Prishtinë, P.nr.543/2016, të dt.19.07.2018, i akuzuari D.J., nga Ferizaji, është liruar nga akuza për veprën penale Mbajtja në pronësi kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, për shkak se nuk është provuar se i akuzuari, ka kryer veprën penale, për të cilën është akuzuar.

Shpenzimet e procedurës penale, kanë ra në barrë të mjeteve buxhetore të asaj gjykate.

Kundër këtij, aktgjykimi me kohë ka ushtruar ankesë:

-Prokuroria Themelore-DKR në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovoj si të bazuar ankesën, aktgjykimin e ankimiur ta prishë ta anulohet dhe çështjen penale ta kthejë në rigjykim dhe vendim.

Prokuroria e Apelit e Kosovës-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj PPA/I.nr.387/18, të dt.14.09.2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe aktgjykimit të gjykatës së shkallës të anulohet dhe çështja penale të kthehet në rigjykim dhe vendim.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar i autorizuari i të akuzuarit D.J. av. K.B., me propozim që ankesa e Prokurorisë Themelore DKR të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par.1 të KPP, në këtë çështje penale nuk caktoi seancën e kolegjit, për arsye se kemi të bëjmë me aktgjykim lirues dhe mbajtja e seancës së kolegjit nuk është e domosdoshme.

Gjykata e Apelit, në bazë të nenit 394 par.1 të KPP, duke vlerësuar pretendimet ankimore të PTH-DKR në Prishtinë, edhe sipas detyrës zyrtare, e bashkë me te edhe aktgjykimin e ankimuar, e duke marr parasysh edhe mendimin me shkrim të paraqitur nga ana e Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës gjeti se:

Ankesa e PTH-DKR në Prishtinë, është e pabazuar.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

PTH-DKR në Prishtinë, në ankesën në bazat ankimore të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurë penale dhe shkeljes së ligjit penal nuk paraqet asnjë arsye se cilat janë ato shkelje ndërsa sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike pretendon se gjykata e shkallës së parë ka pas prova të mjaftueshme për ta shpallë fajtor të akuzuarin për veprën penale për të cilën është ngrit akuzë, duke marr parasysh se gjykata gabimisht ka vlerësuar se i akuzuari nuk është kryerësi i veprës penale dhe armën është dashtë ta mbaj në shtëpi e jo në veturë, ti përmbahet lejes dhe të kërkoj dhe me kërkesë nga Stacioni Policor, para 5 ditëve leje të veçantë për ta përdorë armën në poligonin e gjuajtjes.

Gjykata e Apelit, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e PTH-DKR në Prishtinë e të cilat janë të mangëta dhe në ankesë nuk paraqitet asnjë fakt vendimtar, gjykata e vlerësoi ankesën edhe sipas kësaj baze ankimore, e sipas detyrës zyrtare, në kuptim të ekzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 394 par.1, dhe gjen se gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta dhe të plotë rreth argumentimit se i akuzuari D.J., nuk është kryes i veprës penale Mbajtja në pronësi kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, dhe në atë aktgjykim janë dhënë arsye të qarta dhe të plota se i akuzuari D.J., ka pas leje për armën e zjarrit HS 9x9mm e cila leje është lëshuar nga organi kompetent, dhe ka dhënë arsye të qarta lidhur me faktin vendimtar se arma e zjarrit HS 9x9mm e cila është gjetur në finok të automjetit Audi A4, e njëjta armë e gjetur, qëllimi nuk ka qenë për të shkuar në poligon për shenjëtari, dhe i akuzuari nuk ka ditur se i ka kaluar afati për leje të posaçme të cilën e ka përdor për shenjëtari edhe për kundër të ekzistimit të lejes valide dhe gjykata drejt ka konkluduar se i akuzuari nuk ka pasur leje speciale për armën e shenjëtarisë deri me ta datën 19.03. 2017, dhe nuk ka ditur se ditën kritike kur është kontrolluar vetura e tij e të cilën e ka vozitur miku i tij F.K., të njëjtën do ta largonte nga vetura dhe gjykata drejtë ka konkluduar se i akuzuari gjerë sa ka pasur leje speciale për bartjen e armës deri në poligon të shenjëtarisë armën e ka bartur vetëm për at kohë, dhe pas skadimit të lejes të njëjtën nuk e ka përdorë pa leje të posaçme për qëllime shenjëtërie. E nga kjo rezulton se aktgjykimin i ankimuar nuk është përfshirë në shkeljet esenciale të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par. 1.12 të KPP-së.

Pretendimet ankimore se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë e të paraqitur në ankesë, nuk janë të bazuara për arsye se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vërtetuar se i akuzuari D.J., për armën HS 9x9 mm ka pasur leje valide, mirëpo nuk ka pas leje

të posaçme për bartjen e saj deri në poligonin e shenjëtarisë, dhe gjykata drejtë ka vetëtuar se i akuzuari D.J. po të kishte ditur se do të hasej nga policia armën nuk do ta kishte mbajtur në veturën e tij Audi A4 e të cilën ia kishte dhënë mikut tij F.K., por të njëjtën armë të zjarrit do ta largonte nga vetura, për arsye se nuk ka pas qëllim që të shkoj në poligon të shenjëtarisë, e përveç kësaj pas skadimit të afatit të lejes së posaçme nuk e ka përdorur armën në poligonin e shenjëtarisë. Kjo gjendje faktike e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit.

Pretendimet ankimore se është shkelur ligji penal në dobi të akuzuarit D.J., janë të pabazuara dhe gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vepruar në bazë të provave të nxjerra në shqyrtimin gjyqësor, e me marrjen e aktgjykimit lirues në bazë të nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPP, për arsye se nuk është provuar se i akuzuari D.J., ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, sipas ligjit për armë dhe sipas dispozitës së nenit 22 për armë shenjëtarie, dhe për qëllime shenjëtarie kërkesën për lëvizje për armë personi e bën në Stacionin Policor në afat prej 5 ditësh para lëvizjes me armë, e kjo dispozitë ligjore e Ligjit për Armë është lidhur me dispozitën e nenit 70 par.3 se personi i cili nuk posedon leje të posaçme për lëvizje me armë, organi kompetent do të refuzoj kërkesën për një ditë, dhe nga kjo del se gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar ligjin penal kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza nga neni 385 par.1 të KPP-së, sepse kemi të bëjmë me çështje administrative e jo me vepër penale.

Prandaj, nga arsyet e përshkruara më lartë u deshtë që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet, ndërsa ankesa e PTH-DKR në Prishtinë, të refuzohet si e pa bazuar, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.409/2018, me dt.10.10.2018

Procesmbajtësi,

Sadik Kryeziu

Anëtarët e Kolegjit,

Fillim Skoro

Have Haliti

Kryetare e Kolegjit,

Tonka Berishaj